

Instrumentet për Asistencën e Para-Aderimit II

Mbështetja e BE-së për parandalimin e përmbytjeve dhe menaxhimin e rrezikut nga zjarret në pyje Në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi – IPA Përmbytjet dhe Zjarret

Programi

IPA Përmbytjet dhe Zjarret

Autoriteti Kontraktor

Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Mbrojtjen Civile dhe Operacionet e Ndihmës Humanitare (DG ECHO)

Konsorciumi

Departamenti Italian i Mbrojtjes Civile (DPC) (*drejtues*)

Administrata e Republikës së Sllovenisë për Mbrojtjen Civile dhe Ndihmën në rast Fatkeqësish (URSZR)

Agjencia Suedeze e Kontigjencave Civile (MSB)

Inspektorati i Përgjithshëm Rumun për Situatat e Emergjencës (IGSU)

Brigada e Shpëtimit nga Zjarri e Rajonit Moravio-Silezian, Republika Çeke (FRB-MSR)

Fondacioni i Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Fatkeqësive, Rumani (CN APELL-RO)

Fondacioni Kërkimor CIMA, Itali (CIMA)

Partnerët

Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Turqi

Kohëzgjatja

36 muaj duke filluar nga 15 nëntor 2020

Buxheti

5 milionë euro

Grupet e synuara

Autoritetet kombëtare të mbrojtjes civile, ministritë, institucionet, komuniteti shkencor, aktorët qendrorë dhe lokalë aktivë në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe zjarret në pyje

Objektivi i përgjithshëm

Nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimi i praktikave më të mira për të mbështetur përfituesit e IPA II për harmonizimin e legjislacionit të tyre me *acquis* të BE-së dhe përshtatja graduale me standardet dhe praktikatat e BE-së në mbrojtjen civile

- ❖ Komponenti 1: përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional në lidhje me Direktivën e BE-së për Përmbytjet (“EUFD”) dhe koordinimi institucional mes të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e EUFD
- ❖ Komponenti 2: përmirësimi i parandalimit, gatishmërisë dhe kapaciteteve për t’iu përgjigjur zjarreve në pyje në nivel qendror, rajonal dhe të BE-së

Rezultatet e pritura:

Për Komponentin 1 (përmbytjet): përmirësimi i kapaciteteve të përfituesve për të zhvilluar Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet dhe për të forcuar Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm për përmbytjet.

Për Komponentin 2 (zjarret në pyje): rritja e kapaciteteve për zhvillimin e metodologjive të harmonizuara në nivel rajonal për vlerësimin e rrezikut nga zjarret në pyje, zhvillimi/përditësimi i vlerësimeve të rrezikut dhe planeve të menaxhimit të rrezikut për zjarret në pyje, duke përfshirë komponentin ndërkufitar, dhe përmirësimi i kapaciteteve rajonale për gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj zjarreve në pyje.

Programi do të ketë shtatë paketa pune, të ndara në dy komponentë:

- 1.1: Rritja e kapacitetit për zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet bazuar në praktikatat e mira të Shteteve Anëtare të BE-së dhe në përputhje me EUFD
- 1.2: Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e planeve të përbashkëta ndërkufitare të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet
- 1.3: Hartimi i procedurave dhe marrëveshjeve për përfshirjen e paralajmërimit të hershëm në planet lokale/qendrore të përgjigjes ndaj emergjencave
- 2.1: Sigurimi i mbështetjes teknike për zhvillimin e vlerësimeve të rrezikut dhe aftësive të menaxhimit të rrezikut për zjarret në pyje
- 2.2: Krijimi, pajisja dhe trajnimi i moduleve të shuarjes së zjarrit në pyjet tokësore në përputhje me Shtojcën II të *Vendimit Zbatues të Komisionit që përcakton rregullat për zbatimin e Vendimit nr. 1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për një Mekanizëm për Mbrojtjen Civile në BE dhe shfuqizimi i Vendimit të Komisionit 2004/277/KE, Euratom dhe 2007/606/KE, Euratom (2014/762/BE)*
- 2.3: Përcaktimi i protokolleve ndërkufitare dhe protokolleve të Mbështetjes së Vendeve Pritëse (HNS) sipas *Udhëzimeve të BE-së për Mbështetjen e Vendeve Pritëse*, me qëllim sigurimin e angazhimit të shpejtë dhe efektiv të moduleve të mbrojtjes civile në rast zjarresh në pyje
- 2.4: Organizimi i ushtrimeve në zyrë dhe në terren në nivel rajonal për modulet e zhvilluara me pjesëmarrjen e moduleve të njëjta nga Shtetet Pjesëmarrëse të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian